

LIGJ
Nr. 47/2022

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRKOMBËTARE NDËRMJET
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BASHKIMIT
EVROPIAN PËR PJESËMARRJEN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË
PROGRAMIN E BASHKIMIT EVROPIAN HORIZONT EVROPA – PROGRAMI
KUADËR PËR KËRKIMIN DHE INOVACIONIN**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërkombëtare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin e Bashkimit Evropian Horizont Evropa – Programi Kuadër për Kërkimin dhe Inovacionin, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 28.4.2022.

Shpallur me dekretin nr. 13612, datë 10.5.2022, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.

MARRËVESHJE NDËRKOMBËTARE
NDËRMJET BASHKIMIT EVROPIAN NGA NJËRA ANË DHE
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NGA ANA TJETËR,
PËR PJESËMARRJEN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË PROGRAMIN E BASHKIMIT
EVROPIAN HORIZONT EVROPA – PROGRAMI KUADËR PËR KËRKIMIN DHE
INOVACIONIN

Komisioni Evropian (në vijim “Komisioni”), në emër të Bashkimit Evropian, njëra Palë, dhe Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë (në vijim “Shqipëria”), Pala tjetër, në vijim referuar si “Palët”,

duke pasur parasysh se Marrëveshja Kuadër ndërmjet Komunitetit Evropian dhe Republikës së

Shqipërisë mbi parimet e përgjithshme për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në Programet e Komunitetit¹ përcakton që termat dhe kushtet specifike, në lidhje me pjesëmarrjen e Shqipërisë në secilin program të veçantë, në veçanti kontributi financiar i pagueshëm, do të përcaktohen me marrëveshje në formën e një Memorandumi Mirëkuptimi, ndërmjet Komisionit, që vepron në emër të Komunitetit dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë”²;

duke pasur parasysh se programi i Bashkimit Evropian Horizont Evropa – Programi Kuadër për Kërkimin dhe Inovacionin u krijua nga Rregullorja (BE) 2021/695 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit³ (në vijim “Programi Horizont Evropa”);

duke marrë parasysh përpjekjet e Bashkimit Evropian për të udhëhequr përgjigjen duke bashkuar forcat me partnerët e tij ndërkombëtarë për të trajtuar sfidat botërore, në përputhje me planin e veprimit për njerëzit, planetin dhe prosperitetin në Agjendën e Kombeve të Bashkuara “Transformimi i Botës sonë: Agjenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm” dhe duke pranuar që kërkimi dhe inovacioni janë shtytësit kryesorë dhe mjetet thelbësore për një rritje të qëndrueshme të udhëhequr nga inovacioni, për konkurrueshmërinë ekonomike dhe aftësinë tërheqëse;

duke njohur parimet e përgjithshme, siç përcaktohen në Rregulloren (BE) 2021/695;

duke njohur objektivat e Zonës Evropiane të Kërkimit, të rinovuar, për të ndërtuar një zonë të përbashkët shkencore dhe teknologjike, për të krijuar një treg të vetëm për kërkimin dhe inovacionin, për të nxitur dhe për të lehtësuar bashkëpunimin midis universiteteve dhe për të shkëmbyer praktikat më të mira dhe një karrierë tërheqëse kërkimore, për të lehtësuar lëvizshmërinë ndërkufitare dhe ndërsektoriale të studiuesve, për të nxitur lëvizjen e lirë të njohurive shkencore dhe inovacionit, për të promovuar respektimin e lirisë akademike dhe lirisë së kërkimit shkencor, për të mbështetur aktivitete të edukimit shkencor dhe të komunikimit, dhe për të inkurajuar konkurrueshmërinë dhe aftësinë tërheqëse të ekonomive pjesëmarrëse, dhe se vendet e asociuara janë partnerë kryesorë në këtë përpjekje;

duke theksuar rolin e partneriteteve evropiane që adresojnë disa nga sfidat më shtrënguese të Evropës përmes bashkërendimit të nismave të kërkimit dhe inovacionit, duke kontribuar në mënyrë të konsiderueshme në ato prioritete të Bashkimit Evropian, në fushën e kërkimit dhe inovacionit që kërkojnë masë kritike dhe vizion afatgjatë, dhe rëndësinë e përfshirjes në këto Partneritete të vendeve të asociuara;

duke marrë parasysh se kërkimi dhe inovacioni, në rajonin e Ballkanit Perëndimor kanë treguar se janë tejet të rëndësishme për bashkëpunimin dhe financimin e projekteve të përbashkëta kërkimore dhe të inovacionit që mundësojnë qasje reciproke në ekselencë, njohuri, inovacion, rrjet dhe burime kërkimore. Kanë ofruar mundësi të vlefshme për zhvillimin njerëzor, duke shtuar mundësitë e suksesit në gjetjen e zgjidhjeve të përbashkëta për sfidat rajonale dhe botërore;

duke kërkuar vendosjen e kushteve reciprokeisht të favorshme për krijimin e vendeve të përshtatshme të punës, për të forcuar dhe mbështetur ekosistemet e inovacionit të Palëve duke ndihmuar ndërmarrjet inovacion dhe rritjen në tregjet e secilës Palë dhe lehtësimin e përfitimit, si dhe të shpërndarjes dhe qasjes në inovacion, përfshirë veprimtari për ngritjen e kapaciteteve;

duke njohur që pjesëmarrja reciproke në programet kërkimore dhe inovative të njëri-tjetrit duhet të sigurojë përfitime reciproke; ndërkohë që pranohet që Palët të rezervojnë të drejtën e tyre për të

¹ OJ L 192, 22.7.2005, f. 2.

² Kjo Marrëveshje përbën dhe ka të njëjtat efekte juridike si një Memorandum Mirëkuptimi i deklaruar, sipas Marrëveshjes Kuadër ndërmjet Komunitetit Evropian dhe Republikës së Shqipërisë mbi parimet e përgjithshme për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programet e Komunitetit.

³ Rregullorja (BE) 2021/695 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 28 prillit 2021 për programin Horizont Evropa – Programi Kuadër për Kërkimin dhe Inovacionin, që përcakton rregullat për pjesëmarrje dhe përhapje, dhe që shfuqizon Rregulloret (BE) 1290/2013 dhe (BE) 1291/2013 (OJ L 170, 12.5.2021, f. 1).

kufizuar ose kushtëzuar pjesëmarrjen në programet e tyre kërkimore dhe inovative, përfshirë veçanërisht veprimtari që lidhen me pasuritë e tyre strategjike, interesat, autonominë ose sigurinë;

duke marrë parasysh që qëllimet e përbashkëta, vlerat dhe lidhjet e forta të Palëve në fushën e kërkimit dhe inovacionit, të përcaktuara më parë përmes Marrëveshjeve të Asociimit me Programet pasuese Kuadër, dhe duke njohur dëshirën e përbashkët të Palëve për të zhvilluar, forcuar, nxitur dhe zgjeruar më tej marrëdhëniet dhe bashkëpunimin e tyre në të,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Qëllimi i asociimit

1. Shqipëria do të marrë pjesë si një vend i asociuar dhe do të kontribuojë në të gjitha pjesët e Programit Horizont Evropa – Programit Kuadër për Kërkimin dhe Inovacionin (Programi Horizont Evropa) referuar në nenin 4 të Rregullores (BE) 2021/695 dhe zbatuar përmes programin specifik të krijuar me anë të vendimit (BE) 2021/764⁴, në versionet e tyre më të përditësuara, dhe përmes një kontributi financiar në Institutin Evropian të Inovacionit dhe Teknologjisë.

2. Rregullorja (BE) 2021/819 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit⁵ dhe vendimi (BE) 2021/820⁶, në versionet e tyre më të përditësuara, do të zbatohen për pjesëmarrjen e personave juridikë shqiptarë në Komunitetet e Njohurisë dhe Inovacionit.

Neni 2

Termet dhe kushtet e pjesëmarrjes në Programin Horizont Evropa

1. Shqipëria do të marrë pjesë në Programin Horizont Evropa në përputhje me kushtet e përcaktuara në Marrëveshjen Kuadër ndërmjet Komunitetit Evropian dhe Republikës së Shqipërisë mbi parimet e përgjithshme për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programet e Komunitetit dhe nën termat dhe kushtet e përcaktuar në këtë Marrëveshje, në aktet ligjore të referuara në nenin 1 të kësaj Marrëveshjeje, si dhe në çdo rregull tjetër që ka të bëjë me zbatimin e Programit Horizont Evropa, në versionet e tyre më të përditësuara.

2. Përveç kur parashikohet ndryshe në termat dhe kushtet e referuar në paragrafin 1 të këtij neni, përfshirë zbatimin e nenit 22, pika 5, të rregullores (BE) 2021/695, personat juridikë të vendosur në Shqipëri mund të marrin pjesë në veprime të tërthorta të Programit Horizont Evropa në kushte të barabarta me ato të zbatueshme për personat juridikë të vendosur në Bashkimin Evropian, përfshirë respektimin e masave kufizuese të Bashkimit Evropian⁷.

3. Para se të vendosë nëse personat juridikë të vendosur në Shqipëri kanë të drejtë të marrin pjesë në veprimtari lidhur me pasuritë strategjike, interesat, autonominë ose sigurinë e Bashkimit Evropian, sipas nenit 22, pika 5 të rregullores (BE) 2021/695, Komisioni mund të kërkojë informacion specifik ose garanci, të tilla si:

a) informacion nëse personave juridikë të vendosur në Bashkimin Evropian u është dhënë ose do

⁴ Vendimi i Këshillit (BE) 2021/764 i 10 majit 2021 që krijon Programin Specifik që zbaton Horizont Evropa – Programin Kuadër për Kërkim dhe Inovacion, dhe që shfuqizon vendimin 2013/743/BE (PJ L 1671, 12.5.2021, f. 1).

⁵ Rregullore (BE) 2021/819 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 20 majit 2021 për Institutin Evropian të Kërkimit dhe Inovacionit (rihartuar) (OJ L 189, 28.5.2021, f. 61).

⁶ Vendimi (BE) 2021/820 i Parlamentit Evropian dhe i Këshillit i 20 majit 2021 për Agjendën Strategjike të Institutit Evropian të Inovacionit dhe Teknologjisë (EIT) 2021–2027: Forcimi i Talenteve dhe i Kapaciteteve të Evropës për Inovacion dhe shfuqizimi i vendimit nr. 1312/2013/BE (OJ L 189, 28.5.2021, f. 91).

⁷ Masat kufizuese të BE-së janë miratuar sipas nenit 29 të Traktatit për Bashkimin Evropian ose në nenin 215 të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian.

t'u jepet akses reciprok në programet dhe projektet ekzistuese të planifikuara të Shqipërisë, të barasvlershme me Horizont Evropën;

b) informacion nëse Shqipëria ka krijuar një mekanizëm kombëtar të kontrollit të investimeve dhe garanci për të cilin autoritetet e Shqipërisë do të raportojnë dhe do të konsultohen me Komisionin për çdo rast të mundshëm, kur në zbatim të një mekanizmi të tillë ata kanë marrë dëgjime për investimet e huaja të planifikuara/blerjen nga një njësi ekonomike e vendosur ose e kontrolluar nga jashtë Shqipërisë, i një personi juridik shqiptar i cili ka marrë fonde nga Horizont Evropa për veprime që lidhen me pasuritë strategjike, interesat, autonominë ose sigurinë e Bashkimit Evropian, me kusht që Komisioni t'i mundësojë Shqipërisë listën e personave juridikë përkatës të vendosur në Shqipëri pas nënshkrimit të marrëveshjeve të grantit me këta persona juridikë; dhe

c) garanci se asnjë prej rezultateve, teknologjive, shërbimeve dhe produkteve të zhvilluara sipas veprimeve në fjalë nga subjektet e vendosura në Shqipëri, nuk do t'u nënshtrohen kufizimeve të eksportit në shtetet anëtare të BE-së, si gjatë veprimit ashtu edhe për katër vjet pas përfundimit të veprimit. Shqipëria do të ndajë një listë të përditësuar të subjekteve të cilat u nënshtrohen kufizimeve të eksportit kombëtar në bazë vjetore, gjatë veprimit, si dhe për katër vjet pas përfundimit të veprimit.

A. Personat juridikë të vendosur në Shqipëri mund të marrin pjesë në aktivitetet e Qendrës së Përbashkët të Kërkimit (JRC/QPK), sipas termave dhe kushteve të barasvlershme me ato të zbatueshme për personat juridikë të vendosur në Bashkimin Evropian, përveç rasteve kur kufizimet janë të nevojshme për të garantuar konsistencë me fushën e pjesëmarrjes që buron nga zbatimi i paragrafëve 2 dhe 3 të këtij neni.

5. Kur Bashkimi Evropian zbaton Programin Horizont Evropa mbështetur në nenet 185 dhe 187 të Traktatit për Funksonimin e Bashkimit Evropian, Shqipëria dhe personat juridikë shqiptarë mund të marrin pjesë në strukturat ligjore të krijuara sipas atyre dispozitave, në përputhje me aktet ligjore të Bashkimit Evropian që janë miratuar ose do të miratohen për krijimin e atyre strukturave ligjore.

6. Përfaqësuesit e Shqipërisë do të kenë të drejtë të marrin pjesë si vëzhgues në komitetin e përmendur në nenin 14 të vendimit (BE) 2021/764, pa të drejtë vote dhe për çështje që ka të bëjë me Shqipërinë.

Këto komitete do të mblidhen pa praninë e përfaqësuesve të Shqipërisë në kohën e votimit. Shqipëria do të informohet për rezultatin.

Pjesëmarrja, siç referohet në këtë paragraf, do të marrë të njëjtën formë, duke përfshirë procedurat për marrjen e informacionit dhe dokumentacionit, si ajo e cila zbatohet për përfaqësuesit nga Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian.

7. Të drejtat e përfaqësimit dhe të pjesëmarrjes së Shqipërisë në Komitetin e Zonës Evropiane të Kërkimit dhe nëngrupet e tij do të jenë ato të cilat janë të zbatueshme për vendet e asociuara.

8. Përfaqësuesit e Shqipërisë do të kenë të drejtë të marrin pjesë si vëzhgues në Bordin e Guvernatorëve të JRC/QPK-së, pa të drejtë vote. Në varësi të këtij kushti, një pjesëmarrje e tillë do të rregullohet nga të njëjtat rregulla dhe procedura të zbatueshme për përfaqësuesit e Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian, përfshirë të drejtën e fjalës dhe procedurat për marrjen e informacionit dhe të dokumentacionit lidhur me një çështje që ka të bëjë me Shqipërinë.

9. Shqipëria mund të marrë pjesë në një Konsorcium Evropian të Infrastrukturës Kërkimore (ERIC/KEIF), në përputhje me Rregulloren e Këshillit (KE) 723/2009, sipas versionit të saj më të përditësuar, dhe në përputhje me aktin ligjor që krijon KEIF⁸.

10. Shpenzimet e udhëtimit dhe shpenzimet për jetesën të kryera nga përfaqësuesit dhe ekspertët shqiptarë për pjesëmarrje si vëzhgues në punën e komitetit referuar në nenin 14 të vendimit (BE)

⁸ Rregullore e Këshillit (BE) nr. 723/2009 e 25 qershorit 2009, për kuadrin ligjor të Komunitetit për një Konsorcium Evropian të Infrastrukturës së Kërkimit (KEIK) (OJ L 206, 8.8.2009, f. 1).

2021/764, ose në takime të tjera lidhur me zbatimin të Programit Horizont Evropa do të rimbursohen nga Bashkimi Evropian sipas të njëjtave rregulla dhe në përputhje me procedurat në fuqi për përfaqësuesit e Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian.

11. Palët do të bëjnë çdo përpjekje, brenda kornizës së dispozitave ekzistuese, për të lehtësuar lëvizjen e lirë dhe qëndrimin e shkencëtarëve pjesëmarrës në aktivitetet e mbuluara nga kjo Marrëveshje dhe për të lehtësuar lëvizjen ndërkufitare të mallrave dhe të shërbimeve të destinuara për t'u përdorur në këto aktivitete.

12. Shqipëria do të marrë të gjitha masat e nevojshme, sipas rastit, për të siguruar që mallrat dhe shërbimet, të blera në Shqipëri ose të importuara në Shqipëri, të cilat financohen pjesërisht ose tërësisht në përputhje me marrëveshjet e grantit dhe/ose kontratat e lidhura për realizimin e aktiviteteve në përputhje me këtë Marrëveshje, përjashtohen nga detyrimet doganore, detyrimet e importit dhe pagesa të tjera fiskale, përfshirë TVSH-në, që janë të zbatueshme në Shqipëri.

Neni 3 **Kontributi financiar**

1. Pjesëmarrja e Shqipërisë ose e personave juridikë shqiptarë në Programin Horizont Evropa do të jetë subjekt i kontributit financiar të Shqipërisë në Program dhe i kostove përkatëse të menaxhimit, ekzekutimit dhe funksionimit nën buxhetin e përgjithshëm të Bashkimit Evropian (më tej referuar si “buxheti i Bashkimit”).

2. Kontributi financiar do të jetë në trajtën e shumës së:

a) një kontributi operacional:

b) një tarife pjesëmarrjeje.

3. Kontributi financiar do të marrë formën e një pagese vjetore të bërë në (dy) këste dhe do të paguhet jo më vonë se muajt qershor dhe shtator.

4. Kontributi operacional do të mbulojë shpenzimet operative dhe mbështetëse të Programit dhe do të jetë shtesë, si në shumat e përcaktuara si angazhime buxhetore, ashtu edhe si pagesa të shumave të përfshira në buxhetin e Bashkimit Evropian të miratuara përfundimisht për Programin Horizont Evropa, përfshirë çdo shumë të autorizuar buxhetore që përkon me shumat e hequra nga angazhimet buxhetore të vëna përsëri në dispozicion, siç referohet në nenin 15, pika 3, të Rregullores (BE, Euratom) 2018/1046 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit⁹, në versionin e tij më të përditësuar (në vijim “Rregullorja Financiare”), dhe rritur nga të ardhurat e jashtme të caktuara që nuk rezultojnë nga kontributet financiare në Programi Horizont Evropa nga donatorë të tjerë¹⁰,

Për të ardhurat e jashtme të caktuara për Horizont Evropa, sipas nenit 3.1 të Rregullores së Këshillit (BE) 2020/2094, për krijimin e një Instrumenti të Rimëkëmbjes së Bashkimit Evropian, për të mbështetur rimëkëmbjen pas krizës së COVID-19¹¹, kjo rritje do të përkojë me shumat e

⁹ Rregullore (BE, Euratom) 2018/1046 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e 18 korrikut 2018, për rregullat financiare që zbatohen për buxhetin e përgjithshëm të Unionit, që ndryshon Rregulloret (BE) nr. 1296/2013, (BE) nr. 1301/2013, (BE) nr. 1303/2013, (EU) nr. 1304/2013, (BE) nr. 1309/2013, (BE) nr. 1316/2013, (BE) nr. 223/2014, (BE) nr. 283/2014, dhe Vendimi nr. 541/2014/BE dhe që shfuqizon Rregulloren (BE, Euratom) nr. 966/2012 (OJ L 193, 30.7.2018, f. 1).

¹⁰ This includes notably the resources from the European Union Recovery Instrument established by Council Regulation (EU) 2020/2094 of 14 December 2020 establishing a European Union Recovery Instrument to support the recovery in the aftermath of the COVID-19 crisis (OJ L 433I, 22.12.2020, p. 23).

Kjo përfshin veçanërisht burimet nga Instrumenti i Rimëkëmbjes i Bashkimit Evropian i ngritur sipas Rregullores së Këshillit (BE) 2020/2094 e 14 dhjetorit 2020 që krijon një Instrument të Rimëkëmbjes të Bashkimit Evropian për të mbështetur rimëkëmbjen pas krizës së COVID-19 (OJ L 433I, 22.12.2020, f. 23).

¹¹ OJ L 433I, 22.12.2020, f. 23

autorizuara buxhetore vjetore të parashikuara në dokumentet që shoqërojnë projektbuxhetin e Komisionit, për sa i përket Programit Horizont Evropa.,

5. Kontributi fillestar operativ do të bazohet në një kontribut kyç të përcaktuar si raporti i Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) të Shqipërisë sipas çmimeve të tregut ndaj PBB-së së Bashkimit Evropian, sipas çmimeve të tregut. PBB-ja, në çmimet e tregut që do të aplikohet do të përcaktohet nga shërbimet e dedikuara të Komisionit, bazuar në të dhënat më të fundit statistikore të disponueshme për llogaritjet e buxhetit në vitin paraardhës, të vitit kur duhet të kryhet pagesa vjetore. Përjashtim bën vitin 2021, kur kontributi fillestar operacional do të bazohet në PBB-në e vitit 2019, sipas çmimeve të tregut. Rregullimet e këtij kontributi përcaktohen në shtojcën I.

6. Kontributi fillestar operativ do të llogaritet duke përdorur kontributin kyç, të rregulluar, në shumat fillestare të autorizuara si angazhime buxhetore, pjesë të buxhetit të Bashkimit Evropian dhe të miratuara në mënyrë përfundimtare për vitin e caktuar për financimin e Programit Horizont Evropa, në rritje në përputhje me paragrafin 4 të këtij neni.

7. Tarifa e pjesëmarrjes do të jetë 4% e kontributit fillestar operativ vjetor, llogaritur në përputhje me paragrafët 5 dhe 6 të këtij neni dhe do të ndahet në faza, siç përcaktohet në shtojcën I. Tarifa e pjesëmarrjes nuk do t'u nënshtrohet rregullimeve ose korrigjimeve prapavepruese.

8. Kontributi fillestar operativ për një vit N mund të rregullohet retrospektivisht në rënie ose në ulje, në një ose më shumë vite pasuese në bazë të angazhimeve buxhetore të bëra në shumat e autorizuara buxhetore të atij viti N, të cilat rriten në përputhje me paragrafin 4 të këtij neni, zbatimit të tyre përmes angazhimeve ligjore dhe shfuqizimin e atyre angazhimeve. Dispozitat e hollësishme për zbatimin e këtij neni përcaktohen në shtojcën I.

9. Bashkimi Evropian do t'i japë Shqipërisë informacione lidhur me pjesëmarrjen e vet financiare të përfshirë në informacionin për buxhetin, kontabilitetin, performancën dhe vlerësimin, të dhëna të cilat i dërgohen buxhetit të Bashkimit Evropian dhe autoriteteve përkatëse, në lidhje me Programin Horizont Evropa. Ky informacion do të jepet duke respektuar rregullat e konfidencialitetit dhe të mbrojtjes së të dhënave të Bashkimit Evropian dhe të Republikës së Shqipërisë dhe nuk do të cenojë informacionin që Shqipëria ka të drejtë të marrë sipas shtojcës III.

10. Të gjitha kontributet e Shqipërisë ose pagesat nga Bashkimi Evropian, dhe llogaritja e shumave që duhen paguar ose do të merren, do të bëhen në euro.

Neni 4

Mekanizmi automatik i korrigjimit

1. Një mekanizëm automatik i korrigjimit të kontributit fillestar operativ të Shqipërisë për vitin N, do të zbatohet dhe do të llogaritet në vitin N+2, i rregulluar sipas nenit 3, pika 8.

Ajo do të bazohet në performancën e Shqipërisë dhe të personave juridikë shqiptarë në pjesë të Programit Horizont Evropa, të cilat zbatohen përmes granteve konkurruese të financuara nga shumat e autorizuara si angazhime buxhetore të vitit N, të rritura në përputhje me nenin 3, pika 4.

Shuma e korrigjimit automatik do të llogaritet bazuar në ndryshimin ndërmjet:

a) shumës fillestare të angazhimeve ligjore për grante konkurruese të lidhura me Shqipërinë ose persona juridikë shqiptarë të financuara nga shumat e autorizuara si angazhime buxhetore të vitit N, të rritura në përputhje me nenin 3, pika 4; dhe

b) kontributit përkatës operacional të vitit N të paguar nga Shqipëria, të rregulluar sipas nenit 3, pika 8, përjashtuar kostot e mosndërhyrjes së financiar nga shumat e autorizuara si angazhime buxhetore nga viti N, të rritura në përputhje me nenin 3, pika 4.

2. Kur shuma e përmendur në pikën 1, pavarësisht nëse është pozitive ose negative, tejkalon 8% të kontributit fillestar operativ përkatës rregulluar në përputhje me në nenin 3, pika 8, kontributi

filestar operacional i Shqipërisë për vitin N do të korrigohet. Shuma që duhet të merret ose të jepet nga Shqipëria si një kontribut shtesë ose zvogëlim i kontributit të Shqipërisë, sipas mekanizmit të korrigjimit automatik do të jetë shuma që tejkalon këtë prag prej 8%. Shuma nën këtë prag prej 8% nuk do të merret parasysh gjatë llogaritjes së kontributit shtesë si detyrim ose për kompensim.

3. Rregullat e hollësishme për mekanizmin e korrigjimit automatik përcaktohen në shtojcën I.

Neni 5 **Reciprociteti**

1. Personat juridikë të vendosur në Bashkimin Evropian mund të marrin pjesë në programe, projekte të Shqipërisë të barasvlershme me Programin Horizont Evropa, në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.

2. Lista joshteruese e programeve dhe projekteve të Shqipërisë jepet në shtojcën II.

3. Financimi nga Shqipëria i personave juridikë të vendosur në Bashkimin Evropian do t'i nënshtrohet legjislacionit të Shqipërisë që rregullon funksionimin e programeve dhe/ose projekteve të kërkimit dhe inovacionit. Në rastet kur nuk sigurohet financimi, personat juridikë të vendosur në Bashkimin Evropian mund të marrin pjesë me mjetet e tyre.

Neni 6 **Shkenca e hapur**

Palët, reciprokisht, promovojnë dhe nxisin praktika të shkencës së hapur në programet dhe projektet e tyre në përputhje me rregullat e Programit Horizont Evropa dhe legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 7 **Monitorimi, vlerësimi dhe raportimi**

1. Pa cenuar përgjegjësitë e Komisionit, Zyrës Evropiane Kundër Mashtrimit (ZEKM) dhe Gjykatës Evropiane të Audituesve, në lidhje me monitorimin dhe vlerësimin e Programit Horizont Evropa, pjesëmarrja e Shqipërisë në atë Program do të monitorohet vazhdimisht mbi baza partneriteti duke përfshirë Komisionin dhe Shqipërinë.

2. Rregullat lidhur me administrimin e shëndetshëm financiar, përfshirë kontrollin financiar, rikuperimin dhe masa të tjera kundër mashtrimit në lidhje me financimin e Bashkimit Evropian, sipas kësaj Marrëveshjeje, përcaktohen në shtojcën III.

Neni 8 **Komiteti i përbashkët BE–Shqipëri për kërkim dhe inovacion**

1. Do të themelohet Komiteti i përbashkët BE–Shqipëri për kërkim dhe inovacion (në vijim “Komiteti i përbashkët BE–Shqipëri”). Detyrat e Komitetit të përbashkët BE–Shqipëri do të përfshijnë:

a) vlerësimin, çmimin dhe rishikimin e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, në veçanti:

i. pjesëmarrjen dhe performancën e personave juridikë të Shqipërisë në Programin Horizont Evropa,

ii. nivelin e hapjes (reciproke) ndaj personave juridikë të vendosur në secilën Palë për të marrë pjesë në programe dhe projekte të Palës tjetër;

iii. zbatimin e mekanizmit të kontributit financiar dhe mekanizmit automatik të korigjimit në përputhje me nenet 3 dhe 4;

iv. shkëmbimin e informacionit dhe shqyrtimin e pyetjeve të mundshme mbi përdorimin e rezultateve, përfshirë të drejtat e pronësisë intelektuale;

b) diskutimin me kërkesë të secilës Palë të kufizimeve të aplikuara ose të planifikuara nga Palët për qasjen në programet e tyre kërkimore dhe inovative, përfshirë në veçanti për veprimet që lidhen me asetet, interesat, autonominë ose sigurinë e tyre strategjike;

c) shqyrtimin e mënyrës së përmirësimit dhe zhvillimit të bashkëpunimit;

d) diskutimin e përbashkët rreth orientimeve dhe përparësive të politikave të ardhshme lidhur me kërkimin dhe inovacionin dhe planifikimin e kërkimit me interes të përbashkët; dhe

e) shkëmbimin e informacionit, ndër të tjera, mbi legjislacionin e ri, vendimet ose programet kombëtare të kërkimit dhe inovacionit që janë të rëndësishme për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

2. Komiteti i përbashkët BE–Shqipëri, i cili do të përbëhet nga përfaqësues të Bashkimit Evropian dhe të Republikës së Shqipërisë, do të miratojë Rregulloren e tij.

3. Komiteti i përbashkët BE–Shqipëri mund të vendosë të ngrejë grup pune organ këshillimor të posaçëm, në nivel ekspertësh, që mund të ndihmojë në zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

4. Komiteti i përbashkët BE–Shqipëri do të mbledhet të paktën një herë në vit dhe, sa herë e kërkojnë rrethana të veçanta, me kërkesë të ndonjë prej Palëve. Takimet do të organizohen në mënyrë alternative nga Bashkimi Evropian dhe nga ministria përgjegjëse për shkencën në Shqipëri.

5. Komiteti i përbashkët BE–Shqipëri do të punojë në mënyrë të vazhdueshme për shkëmbimin e informacionit përkatës, duke përdorur çdo mjet komunikimi, veçanërisht në lidhje me pjesëmarrjen/performancën e personave juridikë të Shqipërisë. Komiteti i përbashkët BE–Shqipëri veçanërisht mund të kryejë detyrat e tij me shkrim, sa herë të lindë nevoja.

Neni 9

Dispozitat përfundimtare

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën në të cilën Palët kanë njoftuar njëra-tjetrën për përfundimin e procedurave të brendshme, të nevojshme për këtë qëllim.

2. Kjo Marrëveshje do të zbatohet nga 1 janari 2021. Ajo do të mbetet në fuqi për aq kohë sa është e nevojshme, për të gjitha projektet, veprimet, aktivitetet ose pjesë të tyre të financuara nga Programi Horizont Evropa, të gjitha veprimet e nevojshme për të mbrojtur interesat financiarë të Bashkimit Evropian dhe të gjitha detyrimet financiare që burojnë nga zbatimi i kësaj Marrëveshjeje ndërmjet Palëve.

3. Zbatimi i kësaj Marrëveshjeje mund të pezullohet nga Bashkimi Evropian në rast mospagimi të pjesëmëm apo të plotë të kontributit financiar që duhet të paguajë Shqipëria, sipas kësaj Marrëveshjeje.

Në rast të mospagimit, i cili mund të rrezikojë ndjeshëm zbatimin dhe menaxhimin e Programit Horizont Evropa, Komisioni do të dërgojë një letër zyrtare kujtese. Kur brenda 20 ditëve pune pas letres zyrtare të kujtesës, nuk bëhet asnjë pagesë, Komisioni do t'i njoftojë Shqipërisë pezullimin e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje me një letër njoftimi zyrtare, dhe do të hyjë në fuqi 15 ditë pas marrjes së këtij njoftimi nga Shqipëria.

Në rast pezullimi të zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, personat juridikë të vendosur në Shqipëri nuk do të kenë të drejtë të marrin pjesë në procedurat e papërfunduara për dhënien e kontratës/ave kur të hyjë në fuqi pezullimi. Procedura e dhënies së kontratës/ave do të konsiderohet e përfunduar me zbatimin e angazhimeve ligjore si rezultat i kësaj procedure.

Pezullimi nuk prek angazhimet ligjore lidhur me personat juridikë të vendosur në Shqipëri para

hyrjes në fuqi të pezullimit. Kjo Marrëveshje do të vazhdojë të zbatohet për detyrime të tilla ligjore.

Bashkimi Evropian do të njoftojë menjëherë Republikën e Shqipërisë me marrjen e gjithë shumës së kontributit financiar që ajo i detyrohet Bashkimit Evropian. Pezullimi do të hiqet menjëherë pas këtij njoftimi.

Që nga data e heqjes së pezullimit, personat juridikë të Shqipërisë do të gëzojnë përsëri të drejtën për të marrë pjesë në procedurat e dhënies së kontratës/ave, të filluara para kësaj date dhe në procedurat e nisura pas kësaj date, për të cilat afatet e paraqitjes së aplikimeve nuk kanë skaduar.

4. Secila Palë mund ta zgjidhë këtë Marrëveshje në çdo kohë me anë të një njoftimi me shkrim që informon qëllimin e saj për zgjidhje të Marrëveshjes. Zgjidhja [e Marrëveshjes] do të hyjë në fuqi tre muaj kalendariqë pas datës në të cilën njoftimi me shkrim arrin në adresën e marrësit. Data në të cilën zgjidhja hyn në fuqi do të përbëjë datën e zgjidhjes për qëllime të kësaj Marrëveshjeje.

5. Kur kjo Marrëveshje zgjidhet në përputhje me pikën 4, Palët bien dakord, që:

a) projektet, veprimet, aktivitetet ose pjesët e tyre, për të cilat janë parashikuar angazhime ligjore pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje dhe para se kjo Marrëveshjeje të zgjidhet, do të vazhdojnë deri në përfundimin e tyre, sipas kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje;

b) kontributi vjetor financiar i vitit N, gjatë të cilit kjo Marrëveshje zgjidhet, do të paguhet tërësisht në përputhje me nenin 3. Kontributi operacional i vitit N do të rregullohet në përputhje me nenin 3, pika 8, dhe do të korrigjohet në përputhje me nenin 4 të kësaj Marrëveshjeje. Tarifa e pjesëmarrjes e paguar për vitin N nuk do të rregullohet apo korrigjohet;

c) pas vitit gjatë të cilit zgjidhet kjo Marrëveshje, kontributet fillestare operacionale të paguara për vitet gjatë të cilave u zbatua kjo Marrëveshje, do të rregullohen në përputhje me nenin 3, pika 8, dhe do të korrigjohen automatikisht, në përputhje me nenin 4 të kësaj Marrëveshjeje.

Palët, me pëlqim të përbashkët, do të zgjidhin çdo pasojë tjetër që rrjedh nga zgjidhja e kësaj Marrëveshjeje.

6. Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet vetëm me shkrim, me pëlqimin e përbashkët të Palëve. Hyrja në fuqi e ndryshimeve do të ndjekë të njëjtën procedurë si ajo që zbatohet për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

7. Shtojcat e kësaj Marrëveshjeje do të jenë pjesë e pandarë e kësaj Marrëveshjeje.

Kjo Marrëveshje do të hartohet në dy kopje në gjuhën angleze dhe shqipe, ku secili tekst është i barasvlershëm. Në rast mosmarrëveshjeje në interpretim, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

Nënshkruar në Bruksel, më datë 1 shkurt të vitit 2022, dhe në Tiranë, më 9 shkurt 2022.

PËR KOMISIONIN, NË EMËR TË BASHKIMIT EVROPIAN

Mariya Gabriel

KOMISIONAR PËR INOVACIONIN, KËRKIMIN, KULTURËN, ARSIMIN DHE
RININË

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Evis Kushi

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT

SHTOJCA I: Rregullat lidhur me kontributin financiar të Republikës së Shqipërisë në Programin Horizont Evropa (2021–2027)

SHTOJCA II: Listë joshteruese e programeve dhe e projekteve të barasvlershme të Shqipërisë

SHTOJCA I
RREGULLAT LIDHUR ME KONTRIBUTIN FINANCIAR TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË NË PROGRAMIN HORIZONT EVROPA (2021–2027)

I. Llogaritja e kontributit financiar të Shqipërisë

1. Kontributi financiar i Shqipërisë në Programin Horizont Evropa do të përcaktohet në bazë vjetore, në raport me shumën e disponueshme çdo vit në buxhetin e Bashkimit Evropian për shumat e autorizuara si angazhime buxhetore të nevojshme për menaxhimin, ekzekutimin dhe funksionimin e Programit Horizont Evropa, i cili rritet në përputhje me nenin 3, pika 4, të kësaj Marrëveshjeje.

2. Tarifa e pjesëmarrjes, sipas nenit 3, pika 7, të kësaj Marrëveshjeje, do të kalojë në fazat e mëposhtme:

- 2021: 0,5%;
- 2022: 1%;
- 2023: 1,5%;
- 2024: 2%;
- 2025: 2,5%;
- 2026: 3%;
- 2027: 4%.

3. Në përputhje me nenin 3, pika 5, të kësaj Marrëveshjeje, kontributi fillestar operacional që do të paguhet nga Shqipëria për pjesëmarrjen e saj në Programin Horizont Evropa, do të llogaritet për vitet financiare përkatëse, duke aplikuar një rregullim për kontributin kyç.

Përshtatja e kontributit kyç do të jetë:

$$\text{Rregullimi i kontributit kyç} = \text{kontributi kyç} \times \text{koeficienti}$$

Koeficienti i përdorur për llogaritjen e mësipërme për rregullimin e kontributit do të jetë 0.1

4. Në përputhje me nenin 3, pika 8, të kësaj Marrëveshjeje, rregullimi i parë që ka të bëjë me zbatimin e buxhetit të vitit N do të bëhet në vitin N+1 kur kontributi fillestar operacional i vitit N do të rregullohet në rritje ose në zbritje nga diferenca ndërmjet:

a) një kontributi të llogaritur duke aplikuar kontributin e rregulluar të vitit N në shumën e:

i. angazhimeve buxhetore të bëra për shumat e angazhimeve buxhetore të autorizuara për vitin N nën buxhetin e votuar të Bashkimit Evropian dhe për shumat e autorizuara si angazhime buxhetore, që përkojnë me tërheqjen e angazhimeve financiare të vëna përsëri në dispozicion; dhe

ii. çdo shumë e autorizuar e angazhimeve buxhetore bazuar në të ardhurat e jashtme të dedikuara që nuk rezultojnë nga kontributet financiare në programin Horizont Evropa apo nga donatorë të tjerë dhe që ishin në dispozicion në fund të vitit N¹². Për të ardhurat e jashtme të dedikuara për Horizont Evropa, sipas nenit 3, pika 1, të Rregullores së Këshillit (BE) 2020/2094 për krijimin e një Instrumenti të Rikuperimit të Bashkimit Evropian për të mbështetur rimëkëmbjen pas krizës së COVID-19¹³, shumat vjetore treguese në parashikimin e Kornizës Financiare Shumëvjeçare (KFS), do të përdoren për qëllim të llogaritjes së kontributit të rregulluar;

b) dhe kontributit fillestar operacional të vitit N.

¹² Kjo përfshin veçanërisht burimet nga Instrumenti i Rimëkëmbjes së Bashkimit Evropian i themeluar nga Rregullorja e Këshillit (BE) 2020/2094 e 14 dhjetorit 2020 për krijimin e një Instrumenti të Rimëkëmbjes së Bashkimit Evropian për të mbështetur rimëkëmbjen pas krizës COVID-19 (OJ L 433I, 22.12.2020, f. 27).

¹³ OJ L 433I, 22.12.2020, f. 23.

Duke filluar nga N+2, dhe çdo vit pasardhës, derisa të gjitha angazhimet buxhetore të financuara nga shumata e autorizuar si angazhime që vijnë nga viti N, të rritura në përputhje me nenin 3, pika 4, të kësaj Marrëveshjeje, të jenë paguar, dhe 3 vjet pas përfundimit të Programit Horizont Evropa, Bashkimi Evropian do të llogarisë një kontribut operacional të vitit N, duke zvogëluar kontributin operacional të Shqipërisë me shumën e marrë, duke aplikuar rregullimin e kontributit të vitit N me heqjen e angazhimeve financiare të bëra çdo vit mbi përcaktimet e vitit N e financuar nga buxheti i Bashkimit Evropian ose nga angazhimet financiare të vëna përsëri në dispozicion.

Nëse shumata që burojnë nga të ardhurat e jashtme të caktuara për vitin N (për të përfshirë angazhimet financiare buxhetore, dhe shumata sipas Rregullores së Këshillit (BE) 2020/2094, shumata vjetore treguese në parashikimet e KFS-së), që nuk rezultojnë nga kontribute financiare në Programin Horizont Evropa nga donatorë të tjerë anulohen, kontributi operacional i Shqipërisë do të zvogëlohet nga shumata e marrë, duke aplikuar kontributin kyç të rregulluar të vitit N me shumën e anuluar.

II. Korrigjimi automatik i kontributit operacional të Shqipërisë

1. Për llogaritjen e korrigjimit automatik, siç përmendet në nenin 4 të kësaj Marrëveshjeje, do të zbatohen modalitetet e mëposhtme:

a) “grante konkurruese” janë grante të dhëna përmes thirrjeve për propozime ku përfituesit përfundimtarë mund të identifikohen në kohën e llogaritjes së korrigjimit automatik. Përfshihet mbështetja financiare për palët e treta, siç përcaktohet në nenin 204 të Rregullores financiare;

b) në rastet kur një angazhim ligjor nënshkruhet me një konsorcium, shumata e përdorura për të përcaktuar shumata fillestare të angazhimit ligjor janë shumata kumulative të alokuara për përfituesit që janë subjekte shqiptare, në përputhje me ndarjen indikative të buxhetit të marrëveshjes së grantit;

c) të gjitha shumata e angazhimeve ligjore që korrespondojnë me grante konkurruese do të përcaktohen duke përdorur sistemin elektronik të Komisionit Evropian eCorda dhe do të publikohen të mërkurën e dytë të shkurtit të vitit N+2;

d) “kostot e mosndërhyrjes” janë kostot e Programit të ndryshme nga grantet konkurruese, përfshirë shpenzimet e mbështetjes, administrimin specifik të programit, veprime të tjera¹⁴;

e) shumata e alokuara për organizatat ndërkombëtare, si persona juridikë që janë përfitues përfundimtarë¹⁵, do të konsiderohen si kosto të mosndërhyrjes.

2. Mekanizmi do të zbatohet, si më poshtë:

a) Korrigjimet automatike për vitin N, në lidhje me ekzekutimin e ndarjeve buxhetore të detyrueshme për vitin N, të rritura në përputhje me nenin 3, pika 4, të kësaj Marrëveshjeje, do të zbatohen bazuar në të dhënat për vitin N dhe vitin N+1 nga eCorda e përmendur në pikën “c” të paragrafit 1, të pikës II, të kësaj shtojce, në vitin N+2, pasi të jetë zbatuar çdo rregullim në përputhje me nenin 3, pika 8 të kësaj Marrëveshjeje, lidhur me kontributin e Shqipërisë në Programin Horizont Evropa.

Shumata e konsideruar do të jetë shumata e granteve konkurruese për të cilat ka të dhëna të disponueshme, në kohën e llogaritjes së korrigjimit.

b) Duke filluar nga viti N+2 dhe deri më 2029-ën, shumata e korrigjimit automatik do të llogaritet për vitin N duke marrë në konsideratë diferencën ndërmjet:

i. shumës totale të granteve konkurruese të shpërndara në Shqipëri ose subjekteve juridike

¹⁴ “Veprime të tjera” përfshijnë veçanërisht prokurimin, çmimet, instrumentet financiare, veprimet e drejtpërdrejta të Qendrës së Përbashkët të Kërkimit, Pajtimet (OECD, Eureka, IPEEC, IEA, ...), ekspertët (vlerësuesit, monitorimi i projekteve) etj.

¹⁵ Organizatat ndërkombëtare do të konsiderohen si kosto të mosndërhyrjes, vetëm në rast se janë përfituesit fundorë. Kjo nuk do të zbatohet në rastet kur një organizatë ndërkombëtare është koordinatore i një projekti (shpërndan fonde për koordinatore të tjerë).

shqiptare si angazhime lidhur me përcaktimet buxhetore të vitit N; dhe

ii. shumës së kontributit operacional të Shqipërisë të rregulluar për vitin N shumëzuar me raportin ndërmjet:

A. shumës së granteve konkurruese të bëra për shumat e angazhimeve të vitit N, rritur në përputhje me nenin 3, pika 4, të kësaj Marrëveshjeje; dhe

B. totalin e të gjitha shumave buxhetore të autorizuara të angazhimeve buxhetore të vitit N, përfshirë kostot e mospërfshirjes.

III. Pagesa e kontributit financiar të Shqipërisë, pagesa e rregullimeve të bëra në kontributin operacional të Shqipërisë dhe pagesa e korigjimit automatik të zbatueshëm për kontributin operacional të Shqipërisë

1. Komisioni do t'i komunikojë Shqipërisë, sa më shpejt të jetë e mundur dhe jo më vonë se dita kur nxjerr thirrjen e parë për fonde të vitit financiar, informacionin e mëposhtëm:

a) shumat në angazhimet e autorizuara në buxhetin e Bashkimit Evropian të miratuara përfundimisht për vitin në fjalë lidhur me zërat buxhetorë që mbulojnë pjesëmarrjen e Shqipërisë në Programin Horizont Evropa, nëse është e përshtatshme, do të rriten në përputhje me nenin 3, pika 4, të kësaj Marrëveshjeje;

b) shuma e tarifës së pjesëmarrjes e përmendur në nenin 3, pika 7, të kësaj Marrëveshjeje;

c) nga viti N+1 i zbatimit të Programit Horizont Evropa, zbatimi i shumave të autorizuara si angazhimeve buxhetore përkatëse, që korrespondojnë me vitin buxhetor N, rritur në përputhje me nenin 3, pika 4, të kësaj Marrëveshjeje dhe nivelin e parashikimeve financiare që hiqen nga angazhimet,

d) për pjesën e Programit Horizont Evropa, ku një informacion i tillë është i nevojshëm për të llogaritur korigjimin automatik, nivelin e angazhimeve të marra në favor të personave juridikë shqiptarë, të ndarë sipas vitit përkatës të shumave të autorizuara në buxhet dhe nivelit të përgjithshëm përkatës të angazhimeve.

Në bazë të projektbuxhetit të tij, Komisioni do të sigurojë një vlerësim të informacionit për vitin pasardhës, në pikat "a" dhe "b", sa më shpejt të jetë e mundur dhe jo më vonë se 1 shtatori i vitit financiar.

2. Komisioni do të nxjerrë, jo më vonë se muaji prill dhe qershor i çdo viti financiar, një thirrje për fonde Shqipërisë, që përkon me kontributin e saj, sipas kësaj Marrëveshjeje.

Secila thirrje për fonde parashikon pagesa të gjashtë të dymbëdhjetave të kontributit të Shqipërisë, jo më vonë se 45 ditë pas publikimit të thirrjes për fonde.

Për vitin e parë të zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, Komisioni do të publikojë një thirrje të vetme për fonde, brenda 60 ditëve pas datës në të cilën kjo Marrëveshje fillon të prodhojë efekte juridike.

3. Çdo vit, duke filluar nga viti 2023, thirrja për fonde duhet të pasqyrojë, gjithashtu, shumën e korigjimit automatik të zbatueshëm për kontributin operacional të paguar për vitin N-2.

Thirrja për fondet e publikuara më vonë se muaji prill mund të përfshijë gjithashtu rregullime të kontributit financiar të paguar nga Shqipëria për zbatimin, menaxhimin dhe funksionimin e Programit të mëparshëm kuadër për kërkim dhe Inovacion në të cilin Shqipëria mori pjesë.

Për secilin prej viteve financiare 2028, 2029 dhe 2030, shuma që rezulton nga korigjimi automatik i zbatuar për kontributet operationale të paguara më 2026 dhe 2027 nga Shqipëria ose nga rregullimet e bëra, në përputhje me nenin 3, pika 8, e kësaj Marrëveshjeje do të paguhet nga Shqipëria ose do t'i paguhet asaj.

4. Shqipëria do të paguajë kontributin e saj financiar, sipas kësaj Marrëveshjeje, në përputhje me pikën III të kësaj shtojce. Në mungesë të pagesës nga Shqipëria në datën e caktuar, Komisioni do të dërgojë një letër zyrtare rikujtuese.

Çdo vonesë në pagimin e kontributit financiar do të shkaktojë pagesën e kamatëvonesës nga

Shqipëria, për shumën e papaguar që nga data e caktuar për pagesën.

Norma e interesit për shumën e arkëtueshme që nuk janë paguar në datën e caktuar do të jetë norma e aplikuar nga Banka Qendrore Evropiane për operacionet e saj kryesore të rifinancimit, siç është botuar në vëllimin C të Gazetës Zyrtare të Bashkimit Evropian në fuqi, në ditën e parë kalendarike të muajit në të cilin bie data e caktuar për pagesën, rritur me vlerën një pikë e gjysmë përqindjeje.

SHTOJCA II LISTA JOSHTERUESE E PROGRAMEVE DHE E PROJEKTEVE TË BARASVLERSHME TË SHQIPËRISË

Lista e mëposhtme joshteruese do të njihet si lista me programe, projekte shqiptare të barasvlershme me Programin Horizont Evropa:

- Programi Kombëtar i Kërkimit dhe Zhvillimit.

SHTOJCA III MENAXHIMI I SHËNDETSHËM FINANCIAR MBROJTJA E INTERESAVE FINANCIARË DHE RIKUPERIMI

Neni 1

Shqyrtime dhe auditime

1. Bashkimi Evropian do të ketë të drejtën të kryejë, në përputhje me aktet e zbatueshme të një ose më shumë institucioneve ose organeve të Bashkimit Evropian dhe siç parashikohet në marrëveshjet përkatëse dhe/ose kontratat, të rishikimeve dhe auditimeve teknike, shkencore, financiare ose lloje të tjera në mjediset e çdo personi fizik me banim në Shqipëri ose të ndonjë personi juridik të vendosur në Shqipëri dhe që përfiton fonde të Bashkimit Evropian, si dhe të çdo pale të tretë të përfshirë në zbatimin e fondeve të Bashkimit Evropian që banojnë ose janë vendosur në Shqipëri. Rishikime dhe auditime të tilla mund të kryhen nga agjentët e institucioneve dhe të organeve të Bashkimit Evropian, në veçanti të Komisionit Evropian dhe Gjykata Evropiane e Audituesve ose nga persona të tjerë të mandatuar nga Komisioni Evropian.

2. Agjentët e institucioneve dhe të organeve të Bashkimit Evropian, në veçanti të Komisionit Evropian dhe Gjykatës Evropiane të Audituesve, dhe personat e tjerë të mandatuar nga Komisioni Evropian do të kenë qasje në kantiere, punimet dhe dokumentet (si në version elektronik edhe në version të printuar) dhe në të gjithë informacionin e kërkuar për të kryer auditime të tilla, përfshirë të drejtën e marrjes së një kopjeje fizike/elektronike dhe ekstrakte nga çdo dokument, ose përmbajtjen e çdo mediumi të të dhënave, mbajtur nga personi fizik ose juridik i audituar, ose nga pala e tretë e audituar.

3. Shqipëria nuk do të parandalojë apo të ngrejë ndonjë pengesë të veçantë, për të drejtën e hyrjes në Shqipëri dhe për qasje në mjediset e punës së agjentëve dhe personave të tjerë të përmendur në pikën 2, për shkak të ushtrimit të detyrave të tyre të përmendura në këtë nen.

4. Rishikimet dhe auditimet mund të kryhen, gjithashtu, pas pezullimit të zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, në përputhje me nenin 9, pika 3, ose të ndërprerjes së saj, sipas kushteve të përcaktuara në aktet e zbatueshme të një ose më shumë institucioneve ose organeve të Bashkimit Evropian, si edhe mbështetur në parashikimet e marrëveshjeve përkatëse dhe/ose kontratave lidhur me çdo detyrim ligjor që zbaton buxhetin e Bashkimit Evropian dhe të miratuara nga Bashkimi Evropian, para datës së hyrjes në fuqi të pezullimit të zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, sipas nenit 9,

pika 3, ose ndërprerjes së kësaj Marrëveshjeje.

Neni 2

Mbrojtja ndaj parregullsive, mashtrimeve dhe veprave të tjera penale që prekin interesat financiarë të Bashkimit Evropian

1. Komisioni Evropian dhe Zyra Evropiane Kundër Mashtrimit (ZEKM/OLAF) do të autorizohen të kryejnë hetime administrative, përfshirë kontrolle dhe inspektime në vend, në territorin e Republikës së Shqipërisë. Këto hetime do të kryhen në përputhje me termat dhe kushtet e përcaktuar nga aktet në fuqi të një ose më shumë institucioneve të Bashkimit Evropian.

2. Autoritetet kompetente shqiptare do të informojnë Komisionin Evropian ose ZEKM-në brenda një kohe të arsyeshme për çdo fakt ose dyshim për të cilin kanë marrë dijeni, në lidhje me një parregullsi, mashtrim ose veprimtari tjetër të paligjshme, që prek interesat financiarë të Bashkimit Evropian.

3. Kontrollat dhe inspektimet në vend mund të kryhen në mjediset e çdo personi fizik rezident në Shqipëri ose person juridik të vendosur në Shqipëri dhe që merr fonde të Bashkimit Evropian, si dhe të çdo pale të tretë të përfshirë në zbatimin e fondeve të Bashkimit Evropian, rezidente ose e vendosur në Shqipëri.

4. Kontrollat dhe inspektimet në vend do të përgatiten dhe kryhen nga Komisioni Evropian ose ZEKM-ja në bashkëpunim të ngushtë me autoritetin kompetent shqiptar të caktuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë. Autoriteti i caktuar do të njoftohet përpara një kohe të arsyeshme për objektin, qëllimin dhe bazën ligjore të kontrolleve dhe të inspektimeve, në mënyrë që të jetë në gjendje të ofrojë ndihmë. Për këtë qëllim, zyrtarët e autoriteteve kompetente shqiptare mund të marrin pjesë në kontrollet dhe inspektimet në vend.

5. Me kërkesë të autoriteteve shqiptare, kontrollet dhe inspektimet në vend mund të kryhen së bashku me Komisionin Evropian ose ZEKM-në.

6. Agjentët e Komisionit dhe anëtarë të personelit të ZEKM-së do të kenë qasje në të gjithë informacionin dhe dokumentacionin, përfshirë të dhënat kompjuterike, për operacionet në fjalë, të cilat nevojiten për kryerjen në mënyrën e duhur të kontrolleve dhe të inspektimeve në vend. Në veçanti, ata mund të kopjojnë dokumente të caktuara.

7. Në rastet kur personi, njësia ekonomike ose një palë tjetër e tretë kundërshtojnë kontrollin ose inspektimin në vend, autoritetet shqiptare, duke vepruar në përputhje me rregullat dhe rregulloret kombëtare, do të ndihmojnë Komisionin Evropian ose ZEKM-në, për t'u lejuar atyre të kryejnë detyrën për realizimin e një kontrolli ose inspektimi në vend. Ndihma përfshin marrjen e masave të duhura paraprake, sipas ligjit vendës, veçanërisht për të mbrojtur provat.

8. Komisioni Evropian ose ZEKM-ja do të informojë autoritetet shqiptare për rezultatin e këtyre kontrolleve dhe të inspektimeve. Në veçanti, Komisioni Evropian ose ZEKM-ja do të raportojnë sa më shpejt që të jetë e mundur tek autoriteti kompetent shqiptar çdo fakt ose dyshim, në lidhje me parregullsitë, për të cilat kanë marrë dijeni gjatë kontrollit ose inspektimit në vend.

9. Pa cenuar zbatimin e legjislacionit penal shqiptar, Komisioni Evropian mund të vendosë masa administrative dhe gjobë për personat juridikë ose fizikë të Shqipërisë, që marrin pjesë në zbatimin e një programi ose aktiviteti, në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

10. Për qëllimet e zbatimit të duhur të këtij neni, Komisioni Evropian ose ZEKM-ja dhe autoritetet kompetente shqiptare do të shkëmbejnë rregullisht informacione dhe do të konsultohen me njëra-tjetrën, me kërkesë të njëres prej palëve në këtë Marrëveshje.

11. Në mënyrë që të lehtësohet bashkëpunimi efektiv dhe shkëmbimi i informacionit me ZEKM-në, Shqipëria do të caktojë një pikë kontakti.

12. Informacioni i shkëmbyer midis Komisionit Evropian ose ZEKM-së dhe autoriteteve kompetente shqiptare do të bëhet duke respektuar parimin e konfidencialitetit. Të dhënat personale të përfshira në shkëmbimin e informacionit do të mbrohen në përputhje me rregullat në fuqi.

13. Autoritetet shqiptare do të bashkëpunojnë me Prokurorinë Publike Evropiane për ta lejuar atë të përmbushë detyrën e saj për të hetuar, ndjekur penalisht dhe për të dërguar para gjykatës autorët dhe bashkëpunëtorët e veprave penale që prekin interesat financiarë të Bashkimit Evropian, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 3

Rikuperimi dhe zbatimi

1. Vendimet e miratuara nga Komisioni Evropian, që vendosin një detyrim financiar ndaj personave juridikë ose fizikë të ndryshëm nga shtetet, në lidhje me çdo pretendim që buron nga Programi Horizont Evropa, do të jenë të zbatueshme në Shqipëri. Urdhri për ekzekutimin do t'i bashkëngjitet vendimit, pa ndonjë formalitet tjetër përveç verifikimit të vërtetësisë së vendimit nga autoriteti kombëtar i caktuar për këtë qëllim nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë do t'ia bëjë të njohur autoritetin e caktuar kombëtar Komisionit dhe Gjykatës Evropiane e Drejtësisë. Në përputhje me nenin 4, Komisioni Evropian gëzon të drejtën të njoftojë drejtpërdrejt personat rezidentë në Shqipëri dhe personat juridikë të vendosur në Shqipëri, vendime të tilla të zbatueshme. Zbatimi do të bëhet në përputhje me legjislacionin dhe rregullat e procedurës shqiptare.

2. Vendimet dhe urdhrat e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë të marra në zbatim të një klauzole arbitrazhi të parashikuar në një kontratë ose marrëveshje, në lidhje me programet, aktivitetet, veprimet ose projektet e Bashkimit Evropian, do të jenë të zbatueshme në Shqipëri në të njëjtën mënyrë, si vendimet e Komisionit Evropian të përmendura në pikën 1.

3. Gjykata Evropiane e Drejtësisë ka juridiksion për të shqyrtuar ligjshmërinë e vendimit të Komisionit të përmendur në pikën 1 dhe për të pezulluar zbatimin e tij. Sidoqoftë, gjykatat e Shqipërisë do të kenë juridiksion mbi ankesat lidhur me zbatimin në mënyrë të parregullt.

Neni 4

Komunikimi dhe shkëmbimi i informacionit

Institucionet dhe organet e Bashkimit Evropian të përfshira në zbatimin e Programit Horizont Evropa ose në kontrollet mbi atë program do të kenë të drejtë të komunikojnë drejtpërdrejt, përfshirë përmes sistemeve të shkëmbimit elektronik, me çdo person fizik rezident në Shqipëri ose person juridik të vendosur në Shqipëri dhe që merr fonde nga Bashkimi Evropian, si dhe me çdo palë e tretë rezidente ose të vendosur në Shqipëri dhe të përfshirë në implementimin e fondeve të Bashkimit Evropian. Këta persona, subjekte dhe palë të treta mund t'i paraqesin drejtpërdrejt institucioneve dhe organeve të Bashkimit Evropian të gjithë informacionin dhe dokumentacionin që u kërkohet të paraqesin mbështetur në legjislacionin e Bashkimit Evropian, i cili është i zbatueshëm për programin e Bashkimit Evropian dhe të kontratave ose marrëveshjeve të lidhura për të zbatuar atë program.